



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Keshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 428, date 2.7.2004

PER

MENYREN E TRANSFERIMIT TE PAKETES SE AKSIONEVE TE MBETURA TE SHOQERISE ANONIME "ALBTELECOM", PAS TRANSFERIMIT TE PAKETES TEK INVESTITORET STRATEGJIKE, "ALBAPOST" SH.A-JA, ISH-PRONARET E TRUALLIT DHE PUNONJESIT E SHOQERISE ANONIME "ALBTELECOM".

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutes, të nenit 9 të Ligjit Nr. 8306, datë 14.03.1998 "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë" dhe të nenit 1 dhe 2 (pika 4) të Ligjit Nr.8810, date 17.05.2001 "Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime "Albtelecom" , me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit , Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Paketa e aksioneve të mbetura të shoqërisë anonime "Albtelecom", pas transferimit të paketës tek investitorët strategjike, "Albapost" sh.a-ja, ish-pronarët e truallit dhe punonjësit e shoqërisë anonime "Albtelecom", të transferohet nepermjet ankandit publik .
2. Ngarkohet ministria e Ekonomisë dhe ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

FATOS NANO